



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1904/2 Prot.

Tiranë, më 20.01.2015

VENDIM

“ Për pranimin e ankesës”

Nr. 4, datë 20/01 2015

Bazuar në nenin 23 të Kushtetutës, pikës 3 dhe 5/b të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, nenin 16 të ligjit nr.10279, datë 20.05.2010“Për kundërvajtjet administrative”, pas shqyrtimit të ankesës nr. 1904 Prot., datë 11.12.2014 të Qendrës “Res Publica” me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare” kundër Bashkisë Tiranë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

V Ë R E N:

Qendra “Res Publica”, në cilësinë e kërkuarit ka paraqitur pranë autoritetit publik/Bashkisë Tiranë, kërkesën nr. 272/14 Prot., datë 10.11.2014, vërtetuar kjo me recetën postare nr. RR954420102AA, datë 11.11.2014, me objekt, “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”, në të cilën ka kërkuar të informohet 1) nëse ka një vlerësim për numrin e ndërtimeve pa leje, të ndërtuara gjatë periudhës Prill - Gusht 2013? 2) nëse ka një vlerësim, sa është numri i ndërtimeve pa leje gjatë periudhës Prill - Gusht 2013? 3) nëse ka parashikuar Bashkia ndonjë plan për shembjen e tyre? 4) nëse ka parashikuar ndonjë plan për shembjen e tyre dhe sa është vlerësuar kostoja e planit?.

Nga shqyrtimi i dosjes, vërehet se, Qendra “Res Publica” legjitimohet në depozitimin e ankesës së saj në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga pretendimet e parashtruara në ankesë dhe provat e administruara në dosje rezulton se nga Bashkia Tiranë nuk është përmbushur detyrimi ligjor i parashikuar në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” për të trajtuar kërkesën e paraqitur nga ankuesi, brenda afatit kohor 10 ditë pune.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka kërkuar Bashkisë Tiranë që deri në datë 26.12.2014 të depozitojnë parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Qendra “Res Publica”.

Rezulton se, Bashkia Tiranë nuk ka reaguar edhe në përmbushje të këtij detyrimi. Ligji për të drejtën e informimit ka parashikuar shprehimisht disa veprime që duhet të kryejë autoriteti publik në rast të marrjes së një kërkesë. Paraprakisht, nëse autoriteti publik disponon informacionin e kërkuar, ai është i detyruar të trajtojë kërkesën brenda 10 ditë pune nga depozitimi i saj, e ndërsa për shkaqe të parashikuara në pikën 3 të nenit 15, të shtyjë trajtimin e saj me 5 ditë pune të tjera, duke e njoftuar menjëherë kërkuarin. Gjithashtu, autoriteti publik

gjatë trajtimit të kërkesës detyrohet të vlerësojë dhënien e informacionit për kërkuesin në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin përcaktohet informacioni publik pa kërkesë si dhe me nenin 17 në të cilin përcaktohen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit /dokumentacionit.

Shkelja e konstatuar në këtë rast është mos trajtim i kërkesës brenda afateve të përcaktuara, si rezultat i të cilës nuk është parashtruar informacioni i kërkuar. Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky veprim konsiderohet “refuzim”.

Ligji ka parashikuar se, ky mosveprim konsiderohet kundërvajtje administrative dhe në përputhje me nenin 18/2/a të tij “a) refuzimi i dhënies së informacionit, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, dënohet me 150 000 deri në 300 000 lekë.”.

Në kushte të tilla, kur provohet mos trajtimi i kërkesës brenda afatit të parashikuar në ligj si dhe në mungesë të paraqitjes së parashtrimeve të kërkuara nga Komisioneri, arrihet në përfundim se, ankesa është konform ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe si e tillë ajo duhet pranuar në përputhje me objektin e saj.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 5/b të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”;

### VENDOSA

1. Pranimin e ankesës nr. 1904 prot, datë 11.12.2014 të ankuesit Qendra “Res Publica”.
2. Urdhërimin e Bashkisë Tiranë, të trajtojë kërkesën e ankuesit Qendra “Res Publica” nr. 272/14 Prot., datë 10.11.2014 “Për dhënie të informacionit dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”.
3. Urdhërimin e Bashkisë Tiranë, të informojë dhe parashtrorë informacionin e kërkuar ankuesit Qendra “Res Publica” në përputhje me objektin e kërkesës nr. 272/14 Prot., datë 10.11.2014 “Për dhënie të informacionit dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”, brenda datës 2.02.2015.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të ankohen pranë Gjykatës Administrative në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 20.01.2015.

